



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Nr. 280/2 Prot

Tiranë, më 22.07.2020

**V E N D I M**

Nr.88, datë 22.07.2020

**Mbi përfundimin e procedimit administrativ filluar në bazë të informacionit të kërkesës nr. 279 prot., datë 21.04.2020, të nëpunësit civil \*\*\*\*\* , në lidhje me disa pretendime për parregullsi të kryera/lejuara në procedurën e pezullimit nga shërbimi civil dhe dhënien e masës disiplinore “Largim nga shërbimi civil”**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, pas shqyrtimit të materialit të përgatitur dhe propozimit të paraqitur prej Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, për trajtimin e pretendimeve të ngritura nga nëpunësi \*\*\*\*\*,

**VËREJ SE:**

Nëpërmjet kërkesës së regjistruar pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil me nr. 279 prot., datë 21.04.2020, kërkuesi \*\*\*\*\* ka ngritur pretendimin se njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore pranë Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor Rural nuk ka zbatuar legjislacionin për nëpunësin civil, duke refuzuar kërkesën për pezullimin nga shërbimi civil, si dhe gjatë zhvillimit të ecurisë disiplinore në ngarkim të tij.

Në përfundim të shqyrtimit të materialeve të administruara në kuadër të hetimit administrativ rezulton se, kërkuesi \*\*\*\*\* është nëpunës civil i emëruar në pozicionin “Inspektor”, në Sektorin e Kontrollit për Skemat Kombëtare, në Drejtorinë e Kontrollit, Agropika Sarandë, në Agjencinë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural.

Mosmarrëveshja objekt shqyrtimi e ka fillimin në momentin kur Drejtori i Drejtorisë së Kontrollit, me aktin nr. 937/1 prot., datë 27.02.2020, ka kërkuar fillimin e ecurisë disiplinore

dhe ngritjen e Komisionit Disiplinor për shqyrtimin e shkeljeve të pretenduara se janë kryer prej nëpunësit \*\*\*\*\*. Në përmbajtje të këtij akti administrativ, rezulton se si shkaqe për këtë ecuri disiplinore janë evidentuar braktisja e detyrës për më shumë se 7 ditë punë, si dhe moszbatimi haptazi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale, me pretendimin se ky nëpunës është i punësuar njëkohësisht pranë një kompanie private (*fakte që pasqyrohen në raportin nr. 937 prot., datë 27.02.2020, të eprorit direkt*).

Shkeljet e mësipërme, në kuptim të nenit 57, pika 2, germa c) dhe ç), të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, janë klasifikuar shkelje shumë të rënda dhe për këtë arsye, me urdhrin nr. 121, datë 27.02.2020, të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural, është ngritur Komisioni Disiplinor.

Me shkresën nr. 937/2 prot., datë 28.02.2020, institucioni ka njoftuar nëpunësin në fjalë për shkeljet që i atribuohen, duke i mundësuar edhe garantimin e të drejtave që parashikohen në pikën 7, të nenit 59, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të tilla si e drejta për t’u njoftuar lidhur me fillimin e procedimit, për t’u informuar lidhur me shkeljen faktike të pretenduar dhe provat për kryerjen e saj, e drejta për t’u dëgjuar, për të paraqitur prova, për mbrojtje juridike dhe e drejta për t’u asistuar nga një avokat apo një përfaqësues ligjor.

Me marrjen dijeni për fillimin e procedimit disiplinor, rezulton se, ky nëpunës me shkresën nr. 978 prot., datë 02.03.2020, ka kërkuar pranë njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore të AZHBR, pezullimin nga shërbimi civil, për periudhën 15.03.2020 – 14.09.2020. Në lidhje me shkakun e pezullimit, nëpunësi \*\*\*\*\* ka parashtruar gjëndjen e rëndë shëndetësore të njërit prej familjarëve të tij (babait), duke paraqitur si dokumentacion justifikues epikrizën e lëshuar nga Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, nga ku konstatohet se i ati i kërkuesit ka qenë i shtruar për periudhën 06.11.2019 – 25.11.2019.

Njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore, pasi ka shqyrtuar këtë kërkesë, me vendimin nr. 3, datë 03.03.2020, ka vendosur të mos miratojë kërkesën e nëpunësit \*\*\*\*\* , për pezullimin nga shërbimi civil, duke arsyetuar se kërkesa është jo bindëse.

Më tej, rezulton se, në kuadër të procedimit të shkeljeve të pretenduara ndaj këtij nëpunësi, seanca dëgjimore e caktuar në datë 05.03.2020, nuk është zhvilluar pasi nuk kanë qenë të pranishëm anëtarët e Komisionit Disiplinor, për shkak të përfshirjes së tyre në përgatitjen për thirrjen e Skemave Kombëtare 2020. Nga procesverbali nr. 937/3 prot., datë 05.03.2020, konstatohet se nëpunësi nuk ka qenë i pranishëm, duke mos parashtruar shkaqe për mungesën e tij.

Në zbatim të vendimit nr. 243, datë 24.03.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e gjëndjes së fatkeqësisë natyrore”, rezulton se seancat e datës 25.03.2020 dhe 15.04.2020,

nuk janë zhvilluar për shkak të pamundësisë së anëtarëve të Komisionit Disiplinor për të qenë prezent, si pasojë e kufizimeve të vendosura në kushtet e pandemisë së shkaktuar nga virusi COVID-19, fakt që materializohet me procesverbalin nr. 937/4 prot., datë 25.03.2020 dhe nr. 937/6 prot., datë 15.04.2020.

Gjithashtu, nuk është zhvilluar seanca e datës 21.04.2020 për mbledhjen e Komisionit Disiplinor, pasi nuk kanë qenë të pranishëm, \*\*\*\*\*, anëtar në cilësinë e përfaqësuesit të njësisë përgjegjëse (DAP) dhe nëpunësi \*\*\*\*\*, i cili nëpërmjet komunikimit elektronik ka dërguar raportin mjekësor nr. 2758 rregjistri, datë 20.04.2020, për paaftësi të përkohshme në punë për periudhën 20.04.2020 – 24.04.2020.

Nga përmbajtja e procesverbalit nr. 1267/1 prot., datë 21.04.2020, konstatohet se Komisioni Disiplinor ka konstatuar korrigjime në raportin mjekësor e për këtë arsye e ka vlerësuar si të pasaktë *(nga institucioni është deklaruar se raporti mjekësor nuk ishte dhënë për paaftësi të përkohshme dhe për këtë arsye ishte i korrigjuar)*.

Në këto kushte, në zbatim të pikës h), seksioni B/2 “Njoftimi i nëpunësit civil”, të udhëzimit nr. 1, datë 02.04.2014, të Departamentit të Administratës Publike, “Për elementët kryesorë procedural dhe material të ecurisë dhe shqyrtimit të shkeljeve disiplinore”, Komisioni Disiplinor pasi ka konstatuar mungesën e nëpunësit të proceduar dy herë radhazi, pa shkak të arsyeshëm, ka vendosur të vijojë procedimin disiplinor në mungesë të tij.

Në përfundim të shqyrtimit të shkeljes disiplinore të pretenduar, Komisioni Disiplinor me vendimin nr. 5, datë 21.04.2020, ka vendosur dhënien e masës disiplinore “Largim nga shërbimi civil” të nëpunësit \*\*\*\*\*. Në pjesën arsyetuese të vendimit, Komisioni Disiplinor argumenton se, gjatë procedimit disiplinor është vërtetuar fakti se ky nëpunës, gjatë kohës që vazhonte të ishte i punësuar në institucion, kryente një veprimtari me pagesë, jashtë detyrave funksionale, fakt i cili ka sjellë mungesën e tij të herëpashershme në vendin e punës.

Në lidhje me këtë pretendim, nga anëtarët e Komisionit Disiplinor janë administruar foto, si dhe Vërtetimi elektronik nr. T02054466, datë 15.04.2020, “Për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore për Individin”, lëshuar nga Drejtuesi i Shërbimit të Tatimpaguesve, nga ku konstatohet se nëpunësi \*\*\*\*\*, paralelisht me detyrën e nëpunësit civi, ka qenë i punësuar në një kompani të sektorit privat, prej muajit Janar të 2019 e në vazhdim.

Duke analizuar gjithë sa u parashtrua më sipër, ku përfshihen pretendimet e ankuesit, si dhe dokumentacioni i dërguar nga institucioni, arrihet në përfundimin se, procesi administrativ i kryer nga Komisioni Disiplinor dhe vendimmarrja e tij për lirim nga

shërbimi civil të nëpunësit \*\*\*\*\*\*, janë kryer në përputhje me përcaktimet e legjislacionit të shërbimit civil, për arsyet që do të parashtrihen në vijim.

Në nenin 45, pika 2 dhe nenin 46, pika 1, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, përcaktohet se, nëpunësi civil është i detyruar të shfrytëzojë kohën e punës me efikasitet dhe vetëm për kryerjen e detyrave të tij, duke shmangur çdo konflikt ndërmjet interesit të tij privat dhe interesit publik në ushtrimin e detyrës në shërbimin civil.

Më tej, në nenin 47, pika 1, të po këtij ligji, përcaktohet se nëpunësi ka detyrimin të informojë paraprakisht eprorin e tij për çdo veprimtari me pagesë që kryen jashtë detyrës së tij në shërbimin civil dhe kryerja e një veprimtarie të tillë kërkon lejen me shkrim të titullarit të institucionit.

Nga dokumentacioni i administruar në kuadër të hetimit administrativ, nuk rezultojnë asnjë provë shkresore, nëpërmjet të cilës nëpunësi \*\*\*\*\*\*, të ketë vënë në dijeni eprorin e tij ose titullarin e institucionit në lidhje me punësimin e tij në sektorin privat, fakt që përcakton se kjo veprimtari është kryer pa miratimin përkatës dhe në kundërshtim me ligjin për nëpunësin civil.

Për më tepër, rezultojnë se, nëpunësi \*\*\*\*\*\*, pezullimin nga shërbimi civil e ka kërkuar me tjetër motivacion, konkretisht për shkak të gjëndjes së rëndë shëndetësore të njërit prej familjarëve të tij, duke sjellë një dokumentacion justifikues të hershëm në kohë, që nuk i përlligjet shkakut të kërimit.

Ndërkohë që në pikën 10, gërma c) dhe pikën 12, gërma b), të vendimit nr. 124, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave, *“Për pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil”*, i ndryshuar, njihet e drejta e tij për të kërkuar pezullimin nga shërbimi civil për punësim në aktivitet privat/organizata jofitimprurëse brenda ose jashtë vendit, duke e vërtetuar me kontratën e punës të lidhur me punëdhënësin, e drejtë të cilën rezultojnë të mos e ketë ushtruar.

Nga sa është parashtruar më sipër, në analizë të dokumentacionit të administruar dhe fakteve të çështjes konkrete, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil arrin në përfundimin se pretendimet e ankuesit \*\*\*\*\*\* janë të pabazuara në ligj, pasi refuzimi i kërkesës për pezullim nga shërbimi civil dhe dhënia e masës disiplinore *“Lirim nga shërbimi civil”*, janë kryer në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

#### **Për këto arsye:**

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, në ligjin nr. 44/2015, *“Kodi i Procedurave*

*Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe në nenin 34, pika 1, të të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,*

**VENDOSA:**

1. Përfundimin e procedimit administrativ filluar në bazë të kërkesës nr. 279 prot., datë 21.04.2020, të nëpunësit \*\*\*\*\*, pasi nuk janë evidentuar parregullsi të kryera apo të lejuara në zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil, gjatë procedurës së pezullimit nga shërbimi civil, si gjatë zhvillimit të ecurisë disiplinore në ngarkim të tij.
2. Të njoftohet për këtë vendim Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural, Departamenti i Administratës Publike dhe kërkuesi \*\*\*\*\*.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**